



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 135-Shkurt 2015- ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje gjatë përrimit të shkollave në Vërmicë dhe Gollubovc dhe shënimit të shtatë vjetorit të Pavarësisë



Përmbajtja:

Shkrirja e borës ka bërë që lumi Mirusha të del nga shtrati.....	3
Rrëshqitja e dheut, ka dëmtuar një dritare të shkollës në Shkozë	4
Shënohet dita e gjimnazit “Hamdi Berisha”	5
Kryetari Begaj vizitoi pacientët në hemodializë.....	6
Komuna dhe Policia, pajtohen për forcimin e komiteteve të sigurisë në bashkësi	6
Begaj priti palët.....	7
Vërshime dhe dëme nga shiu i sotëm.....	7
Këshilli i Drejtorëve, mbajti mbledhjen e rregullt.....	8
Fermerët malishevas, ndihmohen me lopë qumështore	9
Ministria e Bujqësisë, premtan ndihmë për Malishevën.....	9
Kryetari Begaj, takoi ministrin Stavileci	10
Kryetari Begaj, vizitoi familjen Zogaj në Mleqan dhe disa fermer	11
Minoritetet të integruara në shoqërinë malishevase	12
Rrahmani: Do të vazhdojmë me luftimin e EHKK	12
Kryetari Begaj, priti nxënësit që kanë fituar një projekt në “kosovision contest”	13
Kryetari Begaj priti arsimtarët shqiptar në Suedi	14
Kryetari Begaj dhe ministri Bajrami, përruruan dy shkolla në Malishevë	15
Aktivitete të shumta me rastin e shënimit të Pavarësisë	16
Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e radhës	19
Kryetari Begaj, priti përfaqësuesit e shoqatës “Miqtë e Amerikës”	19
Kryetari Begaj, takoi banorët e Malishevës dhe Mirushës	20
Begaj, ka vazhduar takimet me banorët e Balincës dhe Llazicës.....	21
Kryetari Begaj, takoi banorët e Burimit dhe Carrallukës	22
Banorët e Senikut dhe Temeqinës, u takuan me kryetarin Begaj	23
Aziz Thaçi u zgjodh kryesues i KK të Malishevës.....	24
U mbajtën garat e matematikanëve të rinj.....	25
Kryetari Begaj takoi banorët e Bardhit dhe Bellanicës	26
Rezultati i garave të matematikanëve të rinj.....	27
Kryetari Begaj priti drejtorin e policisë për rajonin e Gjakovës	28
KKSB, kundër migrimit ilegal	29



Kryetari Begaj, takoi kryetarët e fshatrave	30
U prezantua plani i veprimit për MSA për Komunën e Malishevës.....	31
U mbajtën Garat e Recitatorëve në Komunën e Malishevës.....	32

Shkrirja e borës ka bërë që lumi Mirusha të del nga shtrati

Malishevë, 2 shkurt

Në mbledhjen e rregullt të së hënës, të Këshillit të Drejtorëve, të drejtuar nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, gjatë raportimit të drejtorëve të drejtorive komunale, u bë e ditur, se gjatë ditës së djeshme, lumi Mirusha ka dalë nga shtrati i tij dhe ka shkaktuar vërshime dhe si pasojë, është dashur të intervenohet në urën afër liqenit në Mirushë.

“Shkrirja e shpejt e borës, ka bërë që lumi të dal nga shtrati, pasi është rritur niveli i ujit dhe me njësit e zjarrfikësve dhe shpëtimit, jemi detyruar të intervenojmë në hapjen dhe pastrimin e urës, në rrugën që shkon për në fshatin Gurbardh”, ka raportuar drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina. Sipas tij, janë shkaktuar së paku tri raste të vërshimeve, por bllokimi i urës, afër liqenit ka qenë më problem, pasi është bllokuar rruga, por dëmet materiale janë të vogla.

Përndryshe në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, është biseduar për planifikimet dhe objektivat e drejtorive komunale, për vitin 2015, pastaj përgatitjet për masat parandaluese kundër etheve hemorragjike “krime kongo”-EHKK, si dhe për çështje tjera që lidhen me obligimet dhe shërbimet e përditshme të drejtorive komunale, në raport me qytetarët e Komunës së Malishevës.

Rrëshqitja e dheut, ka dëmtuar një dritare të shkollës në Shkozë

Malishevë, 2 shkurt



Reshjet e mëdha të borës dhe shiut, dhe lagështia e madhe e krijuar në tokë, ka bërë që të shembet një pjesë e dheut dhe gurëve, në afërsi të shkollës së re, në fshatin Shkozë të Malishevës, por për fatin e mirë, kjo shkollë ende nuk është hapur për mësim dhe dëmet e shkaktuar, janë të vogla dhe vetëm materiale.

Për ta vëzhguar këtë rrëshqitje të dheut, sot në fshatin Shkozë, kanë qëndruar edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip

Begaj dhe drejtori i arsimit, z.Blerim Thaçi, ku kanë shprehur shqetësimin e tyre, dhe kanë kërkuar që të bëhet kujdes i shtuar nga ana e drejtorisë së shkollës dhe mësimdhënësve, që mos ti lejojnë nxënësit, të luajnë në afërsi të pjesës ku mund të ketë përsëri shembje dheu.

“Kjo gjendje nuk është e mirë dhe rreziku i rrëshqitjes së dheut, më ka shtyrë, që të mos lejoj hapjen e shkollës, deri në zgjidhjen e problemit, për rregullimin e pjesës mbrojtëse, por kjo aktualisht nuk mund të bëhet, për shkak të kushteve atmosferike dhe konfiguracionit të terrenit”, tha kryetari Begaj.

“Këtë projekt të ndërtimit të shkollës e kemi gjetur kështu, por pas ndërtimit, nuk kam lejuar hapjen e saj, pasi nuk ka siguri, pa u ndërtuar edhe muri mbrojtës nga rrëshqitja e dheut”, deklaroi Begaj, i cili edhe më herët, kishte kërkuar rregullimin e problemit, por për shkak të stinës së dimrit, një gjë e tillë nuk ka mundur të rregullohet deri më tani.

Rrëshqitja e dheut ka dëmtuar pjesërisht një dritare të objektit të shkollës, por pa dëme tjera.

Shënohet dita e gjimnazit “Hamdi Berisha”

Malishevë, 3 shkurt



Me aktivitete të ndryshme, gjimnazi “Hamdi Berisha” në Malishevë, është duke shënuar ditën shkollës, përkatësisht 57 vjetorin e lindjes së profesorit dhe dëshmorit të kombit, Hamdi Berisha, emrin e të cilit e mban gjimnazi. Për ti uruar me rastin e shënimit të kësaj date, gjimnazin “Hamdi Berisha”, sot e ka vizituar edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, z.Blerim Thaçi.

Kryetari Begaj dhe drejtori Thaçi, janë takuar me organet drejtuese të gjimnazit dhe mësimdhënësit, të cilët i kanë uruar me rastin e ditës së gjimnazit. “Ky gjimnaz e mban një emër të madh, emrin e njërit prej personaliteteve më të nderuara të Malishevës, emrin e profesor Hamdi Berishës, i cili përveç kontributit në arsim, një kontribut të jashtëzakonshëm i ka dhënë edhe luftës për liri, madje duke dhënë edhe jetën në luftën heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, tha kryetari Begaj.

“Ne të gjallët, duhet ta arsyetojmë sakrificën e profesor Hamdiut dhe sakrificën e brezave të tërë, që luftuan për lirinë që ne sot gëzojmë. Në veçanti ju profesorët e këtij gjimnazi, duhet ta arsyetoni sakrificën e kolegut tuaj, dëshmorit të kombit Hamdi Berisha, me punën tuaj, në edukimin e nxënësve të këtij gjimnazi”, i porositi kryetari Begaj, mësimdhënësit e gjimnazit “Hamdi Berisha” në Malishevë.

Me rastin e shënimit të Ditës së Gjimnazit “Hamdi Berisha”, do të mbahen disa aktivitete, të organizuara nga mësimdhënësit me nxënësit e këtij gjimnazi, si ekspozita me punime të ndryshme nga nxënësit, pastaj program kulturor dhe artistik dhe aktivitete tjera.

Kryetari Begaj vizitoi pacientët në hemodializë

Malishevë-Prizren, 3 shkurt

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, në kuadër të aktiviteteve të tij, të vizitave dhe takimeve me të gjitha kategoritë e shoqërisë sonë, sot i ka vizituar pacientët nga Malisheva, në repartin e hemodializës në Prizren. Qëllimi i kësaj vizite ishte, që për së afërmi të njihet me gjendjen e tyre shëndetësore si dhe kushtet e trajtimit të tyre.

Me këtë rast, kryetari Begaj, ju ka premtuar, se Komuna e Malishevës, do të vazhdoj të siguroj transportin, për trajtimin e tyre në repartin e hemodializës në Prizren dhe gjithmonë do të jetë në përkrahje të tyre dhe të gjithë qytetarëve të Malishevës, të cilët kanë nevoja të ngjashme të përkujdesjes nga ana e komunës.

Nga ana tjetër, pacientët të cilët gjendeshin sot për trajtim në repartin e hemodializës në Prizren, e kanë falënderuar kryetarin Begaj, për vizitën dhe përkrahjen e vazhdueshme, që Komuna e Malishevës, ka bërë për ta dhe kujdesin shumë të mirë që ju bëhet. Ata u shprehën shumë të kënaqur, pasi për herë të parë një kryetar komune, i viziton ata, direkt në repart, duke u trajtuar.

Komuna dhe Policia, pajtohen për forcimin e komiteteve të sigurisë në bashkësi

Malishevë, 6 shkurt



me stafin dhe koordinatori i EVSB-ve në Malishevë, z.Sejdi Paçarizi.

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot, përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me të cilët kanë biseduar për forcimin e rolit të KKSB-së dhe formimit të komiteteve lokale të sigurisë në bashkësi. Në këtë takim morën pjesë, z.Rifat Marmullaku, nga MPB-ja, majori i policisë, Çlirim Hajdini, nga Policia e Kosovës, komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina,



Sipas majorit Çlirim Hajdini, nga Policia e Kosovës, qëllimi i këtij takimi, është mundësia e forcimit të funksionimit të KKSBB-ve, përkatësisht formimi i trupave tjerë, siç janë komitetet lokale të sigurisë në bashkësi, edhe në Komunën e Malishevës, sikur që janë të formuara edhe në disa nga komunat tjera.

Ndërsa z.Rifat Marmullaku, nga Ministria e Punëve të Brendshme, shpjegoi për qëllimin e formimit të këtyre komiteteve, rolin e tyre, organizimin dhe mënyrën e funksionimit e komiteteve lokale të sigurisë, komitete të cilat, do të luanin një rol të rëndësishëm për komunitetin në përgjithësi.

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, e vlerësoi si shumë të rëndësishme, formimin e këtyre komiteteve dhe tha se “përmes këtyre komiteteve, do të mund të përfitonin shumë, por përfitimi më i madh është, ruajtja e jetës së qytetarëve dhe organizimi ynë si shoqëri, pasi e gjithë bota funksionon në mënyrë të organizuar”. Kryetari Begaj, premtoi përkrahje në formimin e këtyre komiteteve.

Komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina, e falënderoi kryetarin për bashkëpunimin e shkëlqyer të komunës me Policinë e Kosovës, përkrahjen dhe mirëkuptimin e treguar në vazhdimësi.

Begaj priti palët

Malisheve, 6 shkurt

Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj edhe sot ka pritur qytetarët, me hallet e se cilëve u njoh nga afër dhe i dëgjoi për plot tri orë, dhe me këtë rast, ju dha edhe këshillat e nevojshme për ballafaqimin e problemeve të tyre.

Si zakonisht, problem kryesorë i shfaqur nga qytetarët, po vazhdon të jetë ai socio-ekonomike, çështja e punësimit, strehimit dhe disa nevoja tjera nga më të ndryshme, Kryetari Begaj i mirëpriti dhe ju ofroi mbështetjen e tij dhe të komunës si institucion varësisht nga mundësit, dhe u mundua që të ju bëjë zgjidhje rreth shqetësimeve dhe problemeve të tyre që shfaqen sot para tij.

Vërshime dhe dëme nga shiu i sotëm

Malishevë, 6 shkurt



Reshjet e mëdha të shiut, janë përcjellë edhe me vërshime, ku në disa raste është dashur edhe ndërhyrja e njësisë së zjarrfikësve dhe shpëtimit. Këtë e ka konfirmuar drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina, sipas të cilit, këto njësi ju kanë dalë në ndihmë qytetarëve në disa raste, me kërkesën e tyre.

Sipas drejtorit Morina, uji ka vërshuar në afërsi të një prej marketeve në Malishevë, pastaj, në disa shtëpi në lagjen Begaj në Banjë, si dhe në Mirushë, në urën mbi liqenin Mirusha. Në të gjitha këto raste, njësitë e zjarrfikësve dhe shpëtimit kanë intervenuar, për ta larguar ujin dhe hapur urën.

Morina, tha se “të gjitha njësitë e ndërhyrjes, janë në gatishmëri të plotë dhe varësisht nga informatat apo kërkesat e qytetarëve, do të ndërhyjnë”.

Këshilli i Drejtorëve, mbajti mbledhjen e rregullt

Malishevë, 9 shkurt

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, si çdo të hëne, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ku janë trajtuar çështje të ndryshme, që lidhen me aktivitetet e përditshme të drejtorive komunale, përgatitjet për realizimin e projekteve të parapara në investimet kapitale për vitin 2015 dhe çështje të tjera me rëndësi.

Në këtë mbledhje, po ashtu i bisedua edhe përgatitjet për shënimin e 17 Shkurtit, Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ku janë paraparë një varg aktivitetesh. Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, znj.Blerta Krasniqi, drejtorja i ka paraparë aktivitetet që do të mbahen me rastin e shënimit të 17 Shkurtit dhe për këto, qytetarët do të njoftohen me kohë, në mënyrë që të jenë pjesë e këtyre shënimeve, ku parashihet të ketë aktivitete dhe programe të pasura kulturore dhe artistike.

Po ashtu në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, u raportua edhe për vërshimet, ku është dashur intervenimi i njësisë së zjarrfikësve dhe shpëtimit.

Fermerët malishevas, ndihmohen me lopë qumështore

Malishevë, 9 shkurt



Në kuadër të investimeve të Komunës së Malishevës, në fushën e bujqësisë, përkatësisht blegtorisë, me qëllim të përkrahjes të fermerëve vendas, të cilët janë ndihmuar në rritjen e fondit të lopëve qumështore, 21 fermer malishevas janë përkrahur me lopë qumështore. Ky projekt është investim i Komunës së Malishevës dhe kapë një shumë prej rreth 74 mijë eurove.


Sipas drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, z.Hajrullah Mazreku, qëllim i këtij projekti, është “krijimi i kushteve të bashkëfinancimit, për rritjen e fondit të lopëve qumështore në Komunën e Malishevës dhe përfitues të këtij projekti, janë 49 fermer të Komunës së Malishevës, të cilët kanë aplikuar për të qenë përfitues në këtë projekt, dhe të cilët i kanë plotësuar kushtet e parapara”.

“Gjatë kësaj fundjave, është realizuar faza e parë e këtij projekti, ku 21 fermer e kanë marrë nga një lopë qumështore, ndërsa në fazën e dytë, do të përfitojnë edhe 28 fermer të tjerë”, tha drejtori Mazreku, ku sipas tij “faza e dytë e këtij projekti, pritet të realizohet deri në fund të shkurtit”.

“Qëllimi ynë si drejtori dhe si qeveri komunale, është përkrahja e vazhdueshme për të gjithë fermerët vendas, jo vetëm në blegtori, por në të gjitha sektorët e bujqësisë, pasi kjo është dega më e fuqishme e ekonomisë në Komunën e Malishevës”, tha Mazreku, i cili paralajmëroi edhe investime tjera gjatë këtij viti dhe në vitet në vijim për sektorin e bujqësisë.

Ministria e Bujqësisë, premton ndihmë për Malishevën

Prishtinë, 9 shkurt



Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z.Memli Krasniqi priti sot në një takim kryetarin e Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, drejtorin e bujqësisë, z.Hajrullah Mazreku dhe drejtorin për buxhet

dhe financa z.Vesel Krasniqi, me të cilët ka biseduar për Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2015 dhe për skemat e reja të mbështetjes, përmes të cilave ai tha se synojnë fuqizimin e mëtejshëm të sektorit të bujqësisë.

Në këtë drejtim, ministri përmendi se këtë vit kanë paraparë zgjerim të mbështetjes edhe përmes pagesave direkte, të cilat sivjet për herë të parë do të ndahen edhe për pemëtari e për shumë sektor tjerë të bujqësisë.

Me këtë rast, ministri Krasniqi, e njoftoi kryetarin më hollësisht edhe për projektet zhvillimore të kësaj ministrie në kuadër të programit të këtij viti, në të cilat ai tha se mund do të gjejnë mbështetje edhe fermerët e komunës së Malishevës, të cilët janë të dalluar në shumë sektor të bujqësisë e blegtorisë. Ai inkurajoi kryetarin që si komunë të angazhohen në informimin me të madh të fermerëve me mundësitë që kanë për mbështetje nga qeveria, por edhe në këshillimin e tyre për bujqësinë.

Nga ana e tij, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, e uroi ministrin për detyrën dhe e falënderoi për gatishmërinë për avancimin e mëtejshëm të këtij sektori, i cili premtonte edhe zhvillim ekonomik të kësaj komune. Ai e falënderoi ministrin për mbështetjen që MBPZHR-ja ka dhënë për komunën e Malishevës për luftimin e rriqrave në këtë komunë. Ministri Krasniqi tha se kjo mbështetje do të vazhdojë edhe këtë vit, në kuadër të masave që do ta përcaktojë Këshilli Ndërmintor për parandalimin dhe luftimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo.

Kryetari Begaj, takoi ministrin Stavileci

Prishtinë, 9 shkurt



Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, z.Blerand Stavileci, ka pritur sot një takim pune Kryetarin e Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, drejtorin për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi dhe drejtorin për bujqësi, z.Hajrullah Mazrekun, ku kanë biseduar për investime në zhvillimin ekonomik të Malishevës, ku ministri Stavileci ka premtuar bashkëpunim dhe përkrahje për Komunën e Malishevës.



Temë kryesore e këtij takimi ka qenë vazhdimi i zbatimit të marrëveshjes për ndërtimin e ujësjellësit në Senik, ujësjellësi cili do të mbuloj një pjesë të konsiderueshme të fshatrave të Komunës së Malishevës, marrëveshje e cila është nënshkruar vitin e kaluar e ku me bashkëfinancim, mes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Komunës së Malishevës dhe Hidroegjionit jugor, do të ndërtohej ujëmbledhësi në Senik, dhe ujësjellësi për 12 fshatra. Në këtë takim, është biseduar edhe për mundësinë e fillimit të ndërtimit të rrjetit elektrik, nëntokësor, në qytetin e Malishevës dhe tema të tjera, që lidhen projekte që ndikojnë në zhvillimin ekonomik.

Me këtë rast ministri Stavileci, ka premtuar përkrahje për Komunën e Malishevës, përkatësisht zbatimin e marrëveshjes për ndërtimin e ujësjellësit, pastaj edhe përkrahje për projekte tjera.

Ministri Stavileci dhe kryetari Begaj, u pajtuan për bashkëpunim të ndërsjellë, bashkëpunim i cili do të ndikojë në rritjen e zhvillimit ekonomik.

Kryetari Begaj, vizitoi familjen Zogaj në Mleqan dhe disa fermer

Malishevë, 10 shkurt

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, gjatë pasdites së djeshme ka bërë disa vizita, në mesin e tyre edhe familjen e F.Zogajt nga Mleqani, familje e cila ditë më parë kishte deklaruar se do të merrte rrugën e mërgimit, për shkak të kushteve të rënda sociale, por që tani duket të ketë hequr dorë nga kjo, ndërsa dje ka marrë premtimin e kryetarit, se do ta mbështesin këtë familje.

“Ne do ta mbështesim këtë familje, pasi vërtetë jetojnë në kushte të rënda ekonomike, dhe unë i kam premtuar se do ta ndihmojmë në formë të ndryshme, sidomos në bujqësi, në mënyrë që kjo familje të arrijë të krijojë të mira materiale, për sigurimin e jetesës”, ka thënë Begaj pas vizitës në këtë familje.

Po ashtu gjatë pasdites së djeshme kryetari Begaj, ka vizituar edhe disa nga fermerët lokal të Komunës së Malishevës, të cilët janë përfitues në projektin për rritjen e fondit të lopëve qumështore. Me këtë rast fermerët e kanë falënderuar kryetarin dhe komunën për këtë donacion dhe për mbështetjen e herëpashershme në fushën e blegtorisë, përmes subvencioneve të ndryshme, pasi këto mbështetje sa do të vogla, i inkurajojnë blegtorët që të rrisin fondin e lopëve qumështore.

Minoritetet të integruara në shoqërinë malishevase

Malishevë, 12 shkurt



Komiteti për Komunitete, ka mbajtur sot një takim publik me qytetar, përfaqësues të institucioneve dhe shoqërinë civile, me qëllim të raportimit për punën e këtij komiteti dhe hartimin e planit të punës për vitin 2015. Në këtë takim, u vlerësua se minoritetet në Malishevë, janë integruara në shoqëri dhe janë të barabartë me të gjithë qytetarët.

Fillimisht, nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, tha se “këto takime, jo vetëm që ndihmojnë punën e këtij komiteti, por ndihmojnë edhe në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, përfshi edhe komunitetet që jetojnë këtu”. “Komunitetet në Malishevë, janë të integruara mirë në shoqërinë tonë dhe japin kontributin e tyre në zhvillimet e përgjithshme në mënyrë të barabartë. Papunësia është problemi më i theksuar tek ne si shoqëri dhe nuk prekë vetëm komunitetin RAE, por gjithë shoqërinë”, tha Mazreku.

Ndërsa komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina, tha se nga ana e Policisë së Kosovës, nuk është regjistruar asnjë rast i incidenteve ndëretnike në Malishevë, në këto vitet e fundit.

Ndërsa përfaqësuesi i komunitetit RAE, z.Naser Malisheva, që është nënkryetar i komitetit, deklaroi se “komuniteti RAE, nuk është i diskriminuar në asnjë aspekt në Malishevë dhe janë të barabartë, si në shkollim, ashtu edhe në të gjitha fushat tjera të jetës”.

Kryetari Komitetit për Komunitete, z.Fatmir Ademaj, ka prezantuar raportin e punës së komitetit për vitin 2014, e më pas edhe planin e punës për vitin 2015, ndërsa nga takimi, për çka edhe ishte organizuar ky takim, janë marrë edhe sugjerimet dhe propozimet e grupeve të interesit, në hartimin planit të punës për këtë vit.

Ky plan i punës, pas miratimit në Kuvendin e Komunës, do të zbatohet nga ana e komitetit.

Takimi publik i Komitetit për Komunitete, është organizuar në bashkëpunim mes komitetit dhe OSBE-së.

Rrahmani: Do të vazhdojmë me luftimin e EHKK



Malishevë, 12 shkurt



Sot në Malishevë, kanë qëndruar ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, z.Imet Rrahmani, i shoqëruar edhe drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHP), z.Naser Ramadanin, të cilët janë pritur nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha. Qëllimi i kësaj vizite, ishte njoftimi i ndërsjellë i përgatitjeve për masat parandaluese kundër prekjes nga virusi i etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), e ku ministri premtoi përkrahje maksimale nga ana e ministrisë që drejton, në marrjen e t gjitha masave parandaluese kundër EHKK.

Fillimisht kryetari Begaj, pasi e falënderoi për vizitën ministrin Rrahmani, e njoftoi atë për punën që niveli lokal, është duke bërë në këtë drejtim, por kërkoi edhe përkrahje edhe më të madhe nga ana e ministrisë. “Jemi duke bërë gjithçka që kemi mundësi në këtë drejtim, sikur edhe institucionet tjera, duke filluar nga Këshilli ndërministror për EHKK, e deri tek të gjithë mantelbardhët, të cilët kanë dhënë maksimumin e tyre në luftimin e EHKK”, tha kryetari Begaj.

Ministri Rrahmani, tha se është informuar me punën e bërë në këtë drejtim deri më tani. “Shumë shpresoj se suksesi në luftimin dhe parandalimin e EHKK, do të jetë sikur vitin e kaluar ose edhe më mirë dhe unë sot jam këtu, që t’iu shpreh përkrahjen time për të gjithë që janë të angazhuar në këtë drejtim, për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve tanë. Ne nuk guxojmë të vonohemi në zbatimin e strategjisë të hartuar nga këshilli ndërministror dhe gjithmonë duhet të jemi një hap para në realizimin e strategjisë. Po ashtu nuk do të ketë kursime në këtë fushë, pavarësisht vendimeve për zvogëlime në shpenzimeve, por kjo nuk do ta prekë luftimin e EHKK”, tha ministri Rrahmani.

Drejtori i IKSHP-së, z.Naser Ramadani, tha se puna do të vazhdoj me intensitet të njëjtë, por me plotësime të vogla në planin operacional. “Spërkatja selektive, varësisht prej kushteve atmosferike dhe situatës që mund t krijohet, planifikohet të bëhet nga 15 maji, deri më 15 korrik”, tha drejtori i IKSHP-së, z.Naser Ramadani, ndërsa siguroi se në klinikën infektive nuk të do ketë mungesë të ribavirinës, për trajtimin e rasteve eventuale të infektuara me EHKK.

Ndërsa drejtori i drejtorisë komunale për Shëndetësi, z.Hajdin Berisha, e njoftoi ministrin Rrahmani, me përpjekjet e drejtorisë dhe të komunës, në marrjen e masave parandaluese kundër EHKK, si dhe me trajtimin e personave të thumbuar nga rriqrat.”Ne si pushtet lokal, i kemi të qarta detyrimet dhe kompetencat tona dhe jemi të gatshëm që brenda këtij muaji të fillojmë me fushatat tona të informimit për vetëdijesimin e qytetarëve, për kujdesin që të duhet të kenë, në raport me rriqrat dhe rrezikun nga infektimi me EHKK”, tha drejtori Berisha.

Në këtë takim, u bisedua edhe për epideminë e “tularemisë”, e që u bë e ditur se në Komunën e Malishevës, janë të regjistruara katër raste, ndërsa u bë thirrje për kujdes të shtuar dhe pastrim të puseve prej ku furnizohen me ujë për pije. Shfaqja e madhe e minjve dhe vërshimet e ditëve të fundit, kanë bërë minjtë, të dalin në sipërfaqe dhe të mbyten nga uji, e rrjedhimisht edhe të infektohen pusët e ujit, prandaj dezinfektimi i puseve, është një nga masat parandaluese, në raport me tulareminë.

Kryetari Begaj, priti nxënësit që kanë fituar një projekt në “kosovision contest”

Malishevë, 13 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot nxënësit e klasës së pestë, të SHMU “N.Frashëri” në Banjë, të cilët kanë aplikuar në konkursin “Kosovision contest”, ku kanë fituar një donacion për krijimin e bibliotekës së shkollës, e cila i mungon kësaj shkolle. Delegacioni i klasës së pestë, ishte i përbërë nga katër nxënës dhe të shoqëruar nga mësuesi i tyre.

“Unë jam i kënaqur për këtë takim me juve, dhe më i kangur jam me idetë tuaja për shkollën, ide e cila edhe ka arritur të siguroj një përkrahje për ngritjen dhe funksionalizimin e bibliotekës. Mësimi është mbi të gjitha dhe unë dua që ju të mësoni dhe vetëm të mësoni”, ju tha kryetari Begaj, nxënësve të klasës së pestë, të SHMU “Naim Frashëri”.

Nga ana tjetër vetë nxënësit, e prezantuan para kryetarit idenë e tyre për hapjen dhe funksionalizimin e bibliotekës së shkollës, konkurrimin në “Kosovision contest” dhe donacionin prej rreth 500 euro nga ana e MASHT-it, për hapjen e bibliotekës.

Sipas nxënësve kjo shumë, nuk është e mjaftueshme dhe kërkuan edhe përkrahjen e komunës, përderisa kanë premtime edhe nga ana e prindërve për pasurimin e bibliotekës me libra.

Kryetari Begaj, premtoi se do ta mbështes këtë projekt të nxënësve, në mënyrë që biblioteka të hapet dhe të jetë në funksion të nxënësve.

Biblioteka pritet të hapet me datë 23 prill t këtij viti, ndërsa nxënësit e kësaj klase, kanë paraparë edhe aktivitete tjera, në mënyrë që të sigurohet hapja me kohë e bibliotekës dhe pasurimi i saj me libra.

Kryetari Begaj priti arsimtarët shqiptar në Suedi

Malishevë, 16 shkurt

Në pasditen e së dielës, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur një delegacion nga shoqata e arsimtarëve shqiptar në Suedi, me të cilët kanë biseduar për bashkëpunimin e ndërsjellë dhe kontributit të përbashkët në ngritjen e arsimit shqip në Suedi, pasi në këtë shtet jetojnë një numër i madh bashkatdhetarëve shqiptar, përfshi edhe mërgimtar nga Malisheva.

Kryetari Begaj, i ka falënderuar arsimtarët shqiptar, për kontributin e tyre në shkollën shqipe në Suedi, duke e vlerësuar lartë punën e tyre, që fëmijët tanë, të mos e harrojnë gjuhën, kulturën dhe historinë shqiptare, pavarësisht se jetojnë në një vend të huaj. Po ashtu i ka falënderuar edhe për vizitën në Malishevë.

Nga ana tjetër, delegacioni i arsimtarëve shqiptar, e ka ftuar kryetarin Begaj dhe një pjesë të qeverisë komunale, që të marrin pjesë në tridhjetë vjetorin e shkollës shqipe në Suedi.

Njëri nga arsimtarët shqiptar, në Suedi, z.Nuhi Mazreku, i cili është nga Malisheva, përveç falënderimeve për pritjen, po ashtu ka bërë një gjest human, duke dhuruar, 500 euro për familjet e dëshmorëve nga Malisheva, të cilat jetojnë në kushte të vështira, si dhe ka ndihmuar me dy mijë euro, 10 studentë nga Komuna e Malishevës.

Kryetari Begaj dhe ministri Bajrami, përruruan dy shkolla në Malishevë

Malishevë, 16 shkurt



Në kuadër të shënimit të shtatë vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z.Arsim Bajrami, sot kanë përruar dy shkolla, në Vërmicë dhe Gollubovc dhe me këtë rast, ministri Bajrami dhe kryetari Begaj, i kanë uruar nxënësit dhe banorët e këtyre fshatrave, për shkollat e tyre, si

dhe i kanë uruar me rastin e Pavarësisë.

Në takim paraprak, kryetari Begaj, e ka njoftuar ministrin Bajrami, me gjendjen e përgjithshme në Malishevë, me theks të veçantë me infrastrukturën shkollore. “Ne nuk kemi trashëguar pothuajse asgjë nga e kaluara, por sot jemi në përfundim të ndërtimit të të gjitha shkollave. Për të

realizuar këtë, kemi nevojë edhe për mbështetjen tuaj, pasi interesi ynë është të ndërtojmë objekte shkollore me standarde dhe ta rrisim cilësinë në arsim”, tha Begaj.

Ndërsa ministri i MASHT-it, z.Bajrami, tha se “Qeveria e Kosovës dhe ministria që ai drejton, është e fokusuar në rritjen e cilësisë në arsim dhe në depolitizimin e tërësishëm të shkollave. Për këtë unë kërkoj edhe bashkëpunim nga ana e komunave, në mënyrë që ta rrisim cilësinë në arsim”. “Ne jemi të gatshëm që t’ju mbështesim dhe jemi të hapur për bashkëpunim, por kërkoj nga ju që të vazhdoni me mbështetjen në arsim. Unë planifikoj ti takoj të gjithë kryetarët e komunave, me qëllim të bashkëpunimit sa më të mirë, e që përmes këtij bashkëpunimi të arrijmë të rrisim cilësinë”, tha ministri Bajrami.

Ministri Bajrami dhe kryetari Begaj, u dakorduan për rritjen e bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe edukimit, në mënyrë që të krijohen kushte për rritje të cilësisë dhe krijimit të kushteve më të mira në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Shkollat e përruara sot, janë investim i Komunës së Malishevës. Shkolla në Vërmicë, ka një hapësirë prej 1500 metra katrorë dhe buxhetit komunal i ka kushtuar rreth 330 mijë euro, ndërsa shkolla në Gollubovc, ka një hapësirë gjithashtu prej 1500 metrave katrorë dhe i ka kushtuar buxhetit komunal rreth 310 mijë euro.

Aktivitete të shumta me rastin e shënimit të Pavarësisë

Malishevë, 16 shkurt



Në kuadër të shënimit të shtatë vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, janë organizuar një varg aktivitesh solemne, kulturore, sportive, përrurime të ndryshme, si dhe janë nderuar dëshmorët e kombit, me homazhe të varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka mbajtur një mbledhje solemne, ku kanë marr pjesë anëtar të kuvendit, familje të dëshmorëve, përfaqësues të institucioneve lokale, të shoqatave që veprojnë në Malishevë dhe qytetarë të tjerë, ndërsa fjalën kryesore e ka mbajtur Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.



Më pas janë bërë nderime pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, në sheshin e dëshmorëve në Malishevë, pastaj homazhe te varrezat e dëshmorëve të Brigadës 121 në Kleçkë dhe të Brigadës 122 në Malishevë.

Në ndërkohë, është bërë edhe përirimi i dy objekteve të shkollave në Vërmicë dhe Gollubovc, ku mori pjesë edhe ministri i MASHT-it, z.Arsim Bajrami.

Më pas, në mesditë, në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani”, është mbajtur një koncert i pasur kulturor dhe artistik, e ku një fjalë rasti e ka mbajtur edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku.

Në vazhdim, fjalimi i Kryetarit të Komunës, z.Ragip Begaj, mbajtur në seancën solemne, me rastin e shënimit të shtat vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës:

Jemi mbledhur sot, që së bashku të kremtojmë shtatë vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, duke mos harruar me këtë rast përpjekjet dhe sakrificat e brezave të tërë, të cilët sollën datën e madhe historike të 17 shkurtit 2008. Shpallja e Pavarësisë së Kosovës, kurorëzoi ëndrrat dhe aspiratat e popullit tonë që heroikisht gjatë tërë historisë u bëri ballë sfidave.

Kosova, në rrugëtimin e saj qindra vjeçar, gjithmonë ka qenë një njësi administrative, që nga koha e pushtimit turk, kur Kosova ishte vilajet, për të vazhduar të mbetet e ndarë fizikisht nga pjesa tjetër e popullit shqiptar. Pas shumë përpjekjeve, më 1878, u mbajt Lidhja Shqiptare e Prizrenit, me qëllim të formimit të shtetit shqiptar. Lidhja ishte lëvizja e parë e madhe e organizuar politikisht, administrativisht dhe ushtarakisht për të krijuar një rajon të bashkuar shqiptar qysh nga koha e lavdishme e Skënderbeut.

Edhe në vitin 1913, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, Vilajeti i Kosovës, padrejtësisht nga fuqitë e mëdha, përsëri u nda nga pjesa tjetër e kombit, për t’ju dhënë në administrim Serbisë.

Më pas vjen Lidhja e Dytë e Prizrenit, në vitin 1943, që ishte organizim i krerëve nationalist shqiptar. Edhe kjo përpjekje nuk e arrin qëllimin final. Më pas vjen edhe Konferenca e Bujanit, dhjetor 1943- janar 1944, ku sipas rezolutës së dalë nga kjo konferencë, pas fitores ndaj fashizmit, populli shqiptar i Kosovës, të ketë të drejtën e realizimit të aspiratave të tij, për tu bashkuar me Shqipërinë. Edhe kjo nuk u realizua në anë atë periudhë.

Edhe pas Luftës së parë dhe të dytë Botërore, Kosova mbeti në administrimin e ish Jugosllavisë, por si një njësi e veçantë administrative. Megjithatë populli shqiptar kurrë nuk hoqi dorë nga përpjekjet për pavarësi dhe bashkim kombëtar. Në vitin 1990, Kosova u shpall republikë dhe në vitin 1991 shtet i pavarur, mirëpo nuk arriti ta jetësonte pavarësinë e vet në rrethanat e pushtimit ushtarak serb që zgjati plot një dekadë (1989-1999).

Qëndresa mbarëpopullore, Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (1997-1999) dhe ndërhyrja ajrore e NATO-s në pranverë të 1999 i dhanë fund gjenocidit të Serbisë mbi popullatën shqiptare të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe u mbajt edhe konferenca e Rambujesë, që për herë të parë, konsiderohet që faktori ndërkombëtar ishte në krah të kërkesave të popullit shqiptar të Kosovës,



dhe si rrjedhojë, erdhi deri te intervenimi i NATO-s. Kjo mund të konsiderohet edhe si shumë e rëndësishme politikisht, pasi si rrjedhojë e saj, erdhi edhe deri te Shpallja e Pavarësisë së Kosovës.

Kështu, më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli Pavarësinë.

Në shtatë vite të shtetndërtimit, Kosova ka ndërtuar institucionet e saja demokratike, ka shënuar suksese dhe është bërë faktor i paqes në rajon.

Ne edhe sot në këtë ditë të shënuar përkulemi para aktit madhorë të flijimit të komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, përkulemi para të rënëve të të gjithë brezave që janë më meritoret për shtetin e Kosovës.

Shtatë vite pavarësi nuk janë shumë, por ne tashmë jemi dëshmitarë të ndryshimeve rrënjësore pasi Kosova e njohur nga më shumë se njëqind shtetet më të fuqishme të botës është bërë faktor stabiliteti dhe ajo po bëhet pjesë e asaj së cilës i përket gjeografikisht - Evropës së qytetëruar.

Veç kësaj, Kosova tashmë është anëtare e shumë organizmave ndërkombëtar, dhe jemi në rrugë të mirë që së shpejti të jetë edhe anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në këtë ecje dhe në këta përvjetor, Malisheva ka të drejtë të mburret për kontributin e saj në lirinë e Kosovës pasi vetëm gjatë luftës së fundit të UÇK-së i dha Kosovës mbi 70 dëshmor, rreth 400 martir, pothuaj tërë pasurinë e krijuar për decenie e cila u shkatërrua gjatë luftës kurse edhe tash rreth 30 qytetarë të kësaj komune konsiderohen të zhdukur pasi gjatë luftës janë rrëmbyer nga forcat serbe.

Të nderuar pjesëmarrës, zonja dhe zotërinj,

Bashkë me shtetin e Kosovës, në këto shtatë vite ka ecur edhe komuna e Malishevës e cila pikërisht gjatë kësaj periudhe ka shënuar zenitin e zhvillimit dhe të përparimit të saj pasi për përmirësimin e jetës së qytetarit të kësaj komune krahas infrastrukturës rrugore e cila tashmë është rumbullaksuar, ka shënuar suksese të mëdha edhe në fushat tjera.

Të nderuar qytetar të Komunës së Malishevës.

Për ngritjen e një jete më të mirë për qytetarët e komunës së Malishevës, ju ftoj që të vazhdojmë me punën tonë të përbashkët, pasi të gjithë ne kemi një obligim, sepse na obligojnë sakrificat e mëdha të këtij populli, gjaku i derdhur, lufta e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Konsiderojmë se vlera e Pavarësisë së Kosovës matet në radhë të parë me përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe në këtë drejtim ne do të vazhdojmë të punojmë me përkushtim dhe pa u ndalur për ngritjen e projekteve tjera, të cilat do të lehtësojnë jetën e qytetarit të Malishevës pasi ne e meritojmë këtë.

Të nderuar pjesëmarrës, më lejoni edhe njëherë t'ju uroj për shtatë vjetorin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Urime !

Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e radhës

Malishevë, 16 shkurt

Komiteti për Komunitete, ka mbajtur sot mbledhjen e radhës, ku ka trajtuar disa çështje me rëndësi që lidhen me punën dhe aktivitetet e këtij komiteti, prej ku edhe dolën disa rekomandime dhe propozime për punën e tyre në vazhdim. Nga mbledhje sotme, u propozuan dy rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

Fillimisht, kryetari i këtij komiteti, z.Fatmir Ademaj, e vlerësoi lartë debatin e komitetit me institucionet dhe shoqërinë civile, prej ku sipas tij, doli që komuniteti RAE është i inkuadruar mirë në shoqëri dhe nuk ka probleme.

Më pas, komiteti, mori vendim për ti vizituar disa shkolla në Komunën e Malishevës, me qëllim të vlerësimit të dukurisë së braktisjes së shkollimit, me theks të veçantë nga komunitetet, si pasojë e migrimit në shtetet evropiane.

Ndërsa në shqyrtimin e materialit, të mbledhjes së ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës, komiteti dha dy rekomandime, për ti propozuar në mbledhjen e KK-së. e para lidhur me rregulloren për bursa për student dhe dyta për rregulloren për taksa komunale, ku u propozua që komunitetet e caktuara të kenë lehtësira.

Kryetari Begaj, priti përfaqësuesit e shoqatës “Miqte e Amerikës”

Malishevë, 20 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur në një takim pune, përfaqësuesin e shoqatës “Miqte e Amerikës”, z.Agim Rexhepi, me të cilin janë dakorduar për vazhdimin e procedurave, për shpalljen e ish ambasadorit amerikan Christopher Hill

“Qytetar nderi” i Malishevës, si dhe kanë biseduar për çështje tjera.

Kryetari Begaj, pasi i falënderoi për vizitën dhe angazhimin e shoqatës, në fuqizimin e respektimit të miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet tjera mike të Kosovës, tha se “Komuna e Malishevës, do të vazhdoj me procedurat për iniciativën e shoqatës “Miqhtë e Amerikës, për shpalljen e C.Hill, “Qytetar nderi” i Malishevës.

Ndërsa, themeluesi i shoqatës “Miqhtë e Amerikës”, z.Agim Rexhepi, e njoftoi kryetarin me angazhimet e shoqatës në fuqizimin e miqësisë mes SHBA-va dhe Kosovës, kontaktet e shoqatës me personalitetet e ndryshme, me ndikim në shtetin më të fuqishëm në botë, njëherit të shtetit i cili ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për Kosovën, para dhe pas luftës.

Iniciativa për shpalljen qytetar nderi i Malishevës, për ish ambasadorin amerikan, Christopher Hill, ka ardhur si rezultat i lidhjeve të krijuara mes Malishevës si trevë dhe Hill-it, gjatë luftës së UÇK-së, vizitat e tij në Dragobil dhe vende tjera, takimet me krerët e UÇK-së, si dhe pas luftës, po ashtu vizita në përrurimin e rehabilitimit të ujësjellësit në Banjë, u tha në këtë takim.

Angazhimi i ambasadorit Hill, gjatë luftës, u vlerësua lartë, dhe siç tha kryetari Begaj, “Christopher Hill, ka merita të jashtëzakonshme në lirinë e Kosovës”.

Realizimi i kësaj iniciative ka filluar në fund të korrik të vitit 2013, ndërsa realizimi i kësaj iniciative, pritet të bëhet në qershorin e këtij viti, me rastin e Ditës së Çlirimit të Malishevës.

Kryetari Begaj, takoi banorët e Malishevës dhe Mirushës

Malishevë, 20 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, me qëllim të rritjes së transparencës dhe njoftimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve të Komunës së Malishevës, me punën e qeverisë komunale, si dhe me qëllim të njoftimit me problemet dhe nevojat e vendbanimeve, nga sot ka filluar takimet e drejtpërdrejta me banorët në vendbanimet e tyre.

Në ditën e parë të këtyre takimeve, kryetari Begaj, i shoqëruar nga nënkryetari Rexhepi

Mazreku dhe drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha, kanë zgjedhur qytetin e Malishevës, për tu takuar me banorët, si dhe fshatin Mirushë, ku i kanë njoftuar qytetarët me planifikimet komunale për investime kapitale për këtë vit, si dhe me masat parandaluese, në luftimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK).

Nga ana tjetër banorët e qytetit të Malishevës, kanë parashtruar para kryetarit Begaj, nevojat e tyre. Ndërtimi i rrugës transite, kanalizimi në lagjen e Hotëve dhe lagjen e Gurit, rregullimi i shtratit të lumit (për parandalimin e përmytjeve, rrugët dhe kanalizimi në lagjen Mirëdita, varrezat e qytetit, qentë endacak dhe ndriçimi në disa pjesë të qytetit, ishin nevojat më emergjente për banorët e qytetit të Malishevës.

Kurse kërkesat për fshatin Mirushë, sipas banorëve janë: rregullimi i rrugës Malishevë-Kijevë dhe vendosja e pengesave në këtë rrugë për eliminimin e rrezikut në rrugën për në shkollë, rregullimi i kanalizimit në disa pjesë të fshatit, asfaltimi i rrugëve, ndotja e liqenit nga kanalizimi që vjen nga Carralluka dhe ndotja e liqenit nga disa kompani që veprojnë afër liqenit, rregullimi i oborrit të shkollës dhe një fushe të sportit, si dhe largimi i mbeturinave në disa deponi ilegale.

Për të gjitha këto kërkesa të banorëve, kryetari Begaj, premtoi se “do të angazhohet maksimalisht, pavarësisht se Komuna e Malishevës ka një buxhet shumë të kufizuar”. “E di që kemi probleme dhe nevoja të shumta, pasi me kohën edhe nevojat janë të ndryshme, por angazhimi ynë nuk do të mungoj dhe ne gjithmonë do të jemi në shërbimin tuaj”, ka thënë kryetari Begaj, para banorëve të Malishevës dhe Mirushës.

Begaj, ka vazhduar takimet me banorët e Balincës dhe Llazicës

Malishevë, 21 shkurt



Në kuadër të takimeve të drejtpërdrejta me qytetarët e Komunës së Malishevës, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, gjatë mbrëmjes së sotme kanë takuar banorët e fshatrave Balincë dhe Llazicë, ka biseduar me banorët për problemet dhe nevojat që kanë këto dy fshatra.

“Qëllimi ynë është, që të jemi sa më afër qytetarëve, që të jemi sa më transparent në raport me juve dhe që ju të njiheni me punët dhe aktivitetet tona, me buxhetin, me mënyrën e ndarjes së buxhetit dhe investimeve dhe krijimit të prioriteteve, duke u bazuar në kërkesat e

juaja”, ju tha kryetari egaj, banorëve të këtyre fshatrave, duke i njoftuar më pas me planet e komunës, për investime, ku përfshihen edhe Balinca dhe Llazica.

Ndërsa drejtori Berisha, i njoftoi me angazhimet e komunës dhe institucioneve tjera, në luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK). “Vitin e kaluar jemi angazhuar me të gjitha forcat dhe në bashkëpunim, në rend të parë me banorët, mund të themi se kemi pasur sukses, pasi nuk kemi asnjë rast që ka përfunduar me fatalitet, ndërsa edhe këtë vit kemi marrë të gjitha masat për luftimin e EHKK”, tha drejtori Berisha, i cili më pas i njoftoi me të gjitha masat që komuna dhe institucionet përgjegjëse janë duke marrë.

Nga ana tjetër, banorët e Balincës, të cilët kishin disa kërkesa, kryesisht në infrastrukturë, kërkesë kryesore e tyre ishte ndërtimi i një nënkalimi, pasi autostrada që shkon në drejtim të Pejës, e ka ndarë fshatin në dy pjesë, dhe tani qarkullimi është shumë i vështirësuar, si për fëmijët që shkojnë në shkollë, ashtu edhe vajte-ardhje mes lagjeve dhe në rastet e varrimeve, pasi një pjesë e fshatit është shkëputur nga varrezat, dhe kur kanë raste varrimi, ju duhen disa kilometra ti kalojnë, për të shkuar te varrezat, sepse përgjatë autostradës që kalon në mes të fshatit, nuk është paraparë asnjë nënkalim.

E banorët e Llazicës, përveç disa kërkesave si në çdo vendbanime tjetër, problem kryesor e kanë ndërtimin e një rruge, që e lidh një pjesë të fshatit, përkatësisht lagjen e Dobrunëve me shkollën dhe ambulancën e fshatit, pasi nxënësit dhe të tjerët detyrohen të shkojnë në shkollë përgjatë autostradës e cila nuk ka as trotuar, është shumë larg dhe janë seriozisht të rrezikuar.

Për të gjitha këto kërkesa, kryetari Begaj, premtoi se komuna do të angazhohet maksimalisht në zgjidhjen e tyre. “Ne kemi një buxhet shumë të kufizuar, madje këtë vit kemi 800 mijë euro më pak në investimet kapitale, por ne jemi në shërbimin tuaj dhe për kërkesat që janë më urgjente, do të bëhet zgjidhje”, tha kryetari Begaj.

Kryetari Begaj, takoi banorët e Burimit dhe Carrallukës

Malishevë, 23 shkurt



Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, në kuadër të takimeve të drejtpërdrejta me banorët e Komunës së Malishevës, mbrëmë ka takuar banorët e fshatrave Burim dhe Carrallukë. Takimet e kryetarit Begaj, me banorët nëpër vendbanimet e tyre, bëhet me qëllim të informimit të drejtpërdrejtë me hallet, problemet dhe nevojat që kanë vendbanimet, në mënyrë që prioritetet e komunës për investimet kapitale, të hartohen duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve.

Fillimisht kryetari Begaj i ka njoftuar me punën e qeverisë komunale, prioritetet dhe me planifikimet për investime në këto dy vendbanime. “Qëllimi im është të dëgjojë për hallet dhe nevojat që ju keni, në mënyrë që të mundohemi të bëjmë zgjidhje për këto nevoja”, ju ka thënë Begaj, banorëve të Burimit dhe Carrallukës. Po ashtu kryetari Begaj, ka folur edhe për pastrimin e ambientit, si një element shumë më rëndësi në ruajtjen e shëndetit të popullatës dhe eliminimit të rrezikut nga hedhja e mbeturinave, vend e pa vend.

Edhe çështja e migrimit, ka qenë një temë që po e trajton kryetari Begaj me qytetar. “E di që kemi shumë halle, kemi një situatë jo të mirë sociale dhe kemi shumë nevoja. Të arriturat e deritanishme si shtet, nuk ato që kemi dëshiruar apo pritur, por kjo rrugë e migrimit ilegal nuk është zgjidhja më e mirë. Unë shpresoj ende se niveli qendror, do të filloj të realizoj ndonjë projekt të zhvillimit ekonomik, në mënyrë që krijohen vende pune, por edhe ne si qeveri lokale, do të mundohemi maksimalisht që ti përkrahim ata që duan të merren sidomos me bujqësi, dhe përmes kësaj të zbusim sadopak papunësinë dhe të krijojmë kushte në zhvillimin e bujqësisë. Prandaj të mundohemi të punojnë në vendin tonë, pasi vetëm në këtë mënyrë ne mund ta forcojmë shtetin dhe vetveten”, ka thënë kryetari Begaj.

Ndërsa drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, i ka njoftuar banorët e këtyre fshatrave, për strategjinë e luftimit të etheve hemorragjike kirme kongo. “Vitin e kaluar, e tërë qeveri komunale, bashkë me institucionet qendrore, kemi qenë të angazhuar në luftimin e EHKK, ndërsa këtë vit, angazhimi komunës, do të jetë edhe më i madh dhe qëllim i yni është zvogëlimi i rrezikut nga EHKK.”, ka thënë Berisha, dhe i ka njoftuar më pas me të gjitha masat parandaluese, duke filluar nga vetëdijesimi, si një element shumë me rëndësi, pastaj repelimi i kafshëve, punimi i tokës, spërkatja e zonave të prekura e deri ta mënyra e trajtimit të rasteve të thumbimit nga rriqrat.

Nga ana tjetër, banorët e fshatit Burim, duke paraqitur kërkesat e shumta për investim në këtë fshat, kërkuan, që të rregullohet kanalizimi në fshat, pasi një pjesë ka probleme me rrjet të kanalizimit, asfaltimi i dy rrugëve dhe një fushë sporti për shkollën e fshatit.

Kurse në Carrallukë, u kërkuar largimi i deponive ilegale të mbeturinave, sidomos mbeturinave inerte, pastaj asfaltimi i disa rrugicave brenda fshatit, rregullimi i disa pusëve të ujës-jellës dhe kanalizimeve, si dhe problem në vete në këtë fshat është edhe çështja e privatizimit të pronave, që dikur kanë qenë, siç thonë banorët, të Carrallukës, e më pas të is NB “Mirusha”, e që tash u janë shitur personave tjerë.

Banorët e Senikut dhe Temeqinës, u takuan me kryetarin Begaj

Malishevë, 24 shkurt



Në vazhden e takimeve të drejtpërdrejta me banorët e Komunës së Malishevës, kryetari Begaj, mbrëmë

është takuar me banorët e fshatrave Temeqinë dhe Senik, me të cilët ka biseduar për çështje të ndryshme, që lidhen me angazhimet e komunës, investimet dhe nevojat e këtyre dy fshatrave. Këto takime me banorët, mbahen me qëllim të informimit të drejtpërdrejtë me hallet dhe nevojat që kanë vendbanimet, dhe përmes kësaj të bëhen edhe prioritetet e komunës, për investimet kapitale.

“Ndoshta nuk kemi mundur edhe shumë të investojmë, por jemi munduar që të investojmë në çdo vendbanim, sikur edhe këtë vit që do të mundohemi të përfshijmë të gjitha vendbanimet me investime të ndryshme, edhe pse si komunë, këtë vit kemi buxhet më të vogël për investime, për 800 mijë euro, sepse qeveria e vendit, i ka zvogëluar investimet kapitale në komuna, për rritje të pagave”, tha Begaj, duke premtuar, se asnjë vendbanim nuk do të mbetet pa ndonjë investim.

Ndërsa drejtori Hajdin Berisha, i ka njoftuar me angazhimet e komunës në zbatimin e strategjisë për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), me masat parandaluese si dhe me kujdesin që qytetarët duhet të kenë, nëse kanë kontakt me rriqra, si pasojë e punës në fusha. “Vitin e kaluar, jemi angazhuar shumë, dhe për fatin tonë të mirë nuk kemi pasur asnjë viktimë, ndërsa këtë vit, do të angazhohemi edhe më shumë, në tentim për ta luftuar këtë virus”, tha drejtori Berisha.

Kryetari Begaj, tha se për fshatin Temeqinë është paraparë përfundimi i fushës së sportit, punimet e së cilës janë ndërprerë për shkak të kushteve atmosferike, pastaj jemi duke parë mundësinë e hapjes së një rruge e cila do ta lidhte Temeqinën me Guncatin, si dhe investime tjera, varësisht prej mundësive buxhetore që krijohen. Kurse për fshatin Senik, planifikohet vazhdimi i kanalizimit deri në kolektorit kryesor, fusha e sportit për shkollën e fshatit, si dhe ujësjellësi për Senik. Kryetari Begaj po ashtu, tha se nuk do të mungojnë investimet në bujqësi.

Nga ana tjetër, në Temeqinë, banorët kërkuar një trotuar, katër rrugë të lagjeve, kanalizim, pastrimin e ambientit dhe rregullimi i ujit të pijes për shkollën, kurse në Senik, banorët kërkuar ndërtimin e kanalizimit në disa lagje, rrugë në lagjen Halitaj, fushën e sportit për shkollën, largimin e mbeturinave në disa deponi ilegale dhe largimin e plehut organik, që disa banor të pandërgjegjshëm i vendosin në afërsi të shtëpive.

Aziz Thaçi u zgjodh kryesues i KK të Malishevës

Malishevë, 24 shkurt



Kuvendi Komunal i Malishevës, sot ka vazhduar me mbajtjen e mbledhjes urgjente, ku pikë kryesore e rendit të ditës ishte zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Me shumicë të votave, kryesues i KK të Malishevës, u zgjodh Aziz Thaçi nga radhët e IQM-së, i cili mori 20 nga 31 votat e mundshme.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, kishte mbetur pa kryesues, pasi ish kryesuesi z.Enver Hoti, ka marrë pozitën e deputetit të Kuvendit të Kosovës.

Në mbledhjen e sotme, ka dhënë betimin, edhe Veton Kastrati, i cili zëvendëson tashmë deputetin Enver Hoti.

Ndërsa në pikën e ndryshme, me kërkesën e kryetarit të komunës dhe drejtorit për buxhet dhe financa, KK mori dy vendime, e para për iniciimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës publike dhe e dyta për bartjen e mjeteve të tejkaluara nga të hyrat vetanake dhe destinimin e tyre, të hyra të cilat janë 171 152.66 euro.

U mbajtën garat e matematikanëve të rinj

Malishevë, 24 shkurt



Sot në kuadër të garave me karakter shkollorë, u mbajtën garat e matematikanëve të rinj, ku morën pjesë nxënësit e klasave të IX-ta, të Klasave të X-ta, XI-ta dhe të klasave të XII-ta.

Garat në lëndën e Matematikës u mbajtën në shkollën Qendra e Kompetencës “ Abdyl Frashëri” në Malishevë, dhe u monitoruan nga Drejtorja e Arsimit dhe Edukimit në Malishevë, dhe nga komisioni, i cili ka realizuar programin e përmbajtjes së testit konkurrues në Matematikë.

Në këtë garë morën pjesë rreth 100 nxënës nga klasat e lartpërmendura.

Ky organizim i tanishëm është bërë në nivel komune, e më vonë do të organizohen edhe në nivel kombëtar e ndërkombëtar, dhe kjo garë e matematikanëve është përkrahur nga Drejtorja e Arsimit Edukimit në Malishevë.

Rezultatet e garës në Lëndën e Matematikës, do të publikohen në ueb faqen e komunës dhe do të njoftohen edhe shkollat pjesëmarrëse në garë.

Kryetari Begaj takoi banorët e Bardhit dhe Bellanicës

Malishevë, 25 shkurt



Në kuadër të takimeve të drejtpërdrejta me banorët e Komunës së Malishevës, me qëllim që komunikimi të bëhet direkt me qytetar, dhe jo nga zyrat, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori për shëndetësi z.Hajdin Berisha, mbrëmë janë takuar me banorët e fshatrave Bardh dhe Bellanicë, me të cilët kanë biseduar për planifikimet e komunës dhe për kërkesat dhe nevojat që kanë banorët e këtyre fshatrave.

“Jemi munduar të punojmë seriozisht dhe kemi arritur të bëjmë investime të ndryshme, në të gjitha fushat e jetës dhe në të gjitha vendbanimet e Malishevës, ku më pak e ku më shumë, e po ashtu edhe buxhetin kemi arritur ta menaxhojmë shumë mirë. Por nëse pyetem se a kemi mundur ti plotësojmë të gjitha nevojat e banorëve, sigurisht që jo, sepse nevojat lindin vazhdimisht. Prioritet i yni edhe këtë vit, do të jetë vazhdimi i luftimit të dukurive negative në institucione. Lufta ime kundër korrupsionit do të vazhdoj”, ka thënë kryetari Begaj, para banorëve të Bardhit dhe Bellanicës, përderisa i ka njoftuar ata edhe me planifikimet komunale, për investime të caktuara në këto dy fshatra.

Ndërsa drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, duke marrë fjalën në këto takime, tha se “komunikimi ynë me qytetarët do të bëhet direkt, duke ardhur ne tek ju, dhe jo vetëm përmes zyrave. Ashtu edhe planifikimet tona për investime, do të bëhet duke i marr kërkesat nga ju, përmes këtyre takimeve dhe këso lloj takime, do të bëjmë së paku dy herë brenda vitit, pasi kryetari Begaj dhe qeveria komunale, vlerëson se kjo është forma më e mirë dhe më e sigurtë e komunikimit me qytetarin”.

Më pas drejtori Berisha, i njoftoi edhe me masat e komunës dhe institucioneve tjera, në zbatimin e strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK). “Vitin e kaluar jemi angazhuar shumë, së bashku me të gjitha institucionet qendrore përgjegjëse për luftimin e EHKK, po këtë vit, aktivitetet tona si komunë, do të jenë me intensitet më të lartë”, tha Berisha.



Në këto takime të mbrëmshme, banorët e Bardhit, kërkuan që në hartimin prioriteteve të komunës, për këtë fshat, riparimi i kanalizimit në fshat dhe rregullimi i kanalizimit në lagjen e Berishëve, riparimi i një rruge të dëmtuar dhe të shikohet mundësia e rregullimit të rrugëve tjera brenda fshatit, dhe prioritet mbi prioritete të jetë pastrimi i ambientit dhe ndalimi i furrave ilegale për përfitimin e gëlqeres, furra të cilat përdorin goma për djegie dhe si rrjedhojë, janë të rrezikuar seriozisht nga ndotja e ambientit dhe nga sëmundjet kancerogjene.

Kurse banorët e Bellanicës, kërkuan që të vazhdohet në ndërtimin e infrastrukturës, në disa rrugë, kanalizime dhe të tjera, pastaj rregullimin e një fushe sporti dhe të një parku në qendër të fshatit, pasi Bellanica, është njëra nga fshatrat e rralla që ka hapësira të gjelbëruara dhe hapësirë të mjaftueshme, pasi nuk ka uzurpime. Po ashtu problem për fshatin, është hedhja e mbeturinave nga ana e fshatrave përreth Bellanicës, rritja e kapacitetit të ujësjellësit, rregullimi i një ure dhe një rruge të shkurtë, me qëllim të hapjes së një hapësire për varreza, pasi varrezat aktuale kanë pak hapësirë, si dhe kërkuan që të shikohet mundësia që ruhen vreshtat e fshatit, pasi janë shumë të vjetra dhe janë në shuarje sipër.

Rezultati i garave të matematikanëve të rinj

Malishevë, 25 shkurt

Nr.	Emri dhe mbiemri i nxënësit	Shkolla	Klasa	Rezultati
1.	Albion Krasniqi	SHFMU”Hilmi Hoti”	IX	Vendi I parë
2.	Urim Hoxha	SHMU” Ruzhdi Xhyliqi”	IX	Vendi I dytë
3	Granit Kastrati	Gjimnazi “ Hamdi Berisha”	X	Vendi I parë
4	Florent Kafexholli	Gjimnazi “ Hamdi Berisha”	XI	Vendi I parë
5	Fitim Hoxha	Gjimnazi “ Hamdi Berisha	XI	Vendi I dytë
6	Arianit Morina	Gjimnazi “ Hamdi	XII	Vendi I parë

		Berisha”		
7	Alban Gashi	Gjimnazi “ Hamdi Berisha”	XII	Vendi I dytë

Po ashtu këta do të jenë nxënësit, të cilët do të na përfaqësojnë në Olimpiadën e Matematikanëve të rinj.

Kryetari Begaj priti drejtorin e policisë për rajonin e Gjakovës

Malishevë, 26 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Policisë (DRP) në Gjakovë, nënkolonelin Ahmet Hasi, me të cilin ka diskutuar disa çështje, që lidhen me organizimin e Policisë së Kosovës, pas formimit të rajonit të Gjakovës, si dhe për çështje tjera të sigurisë së përgjithshme.

“Kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Policinë e Kosovës dhe Malisheva është një vend i qetë në aspektin e sigurisë

dhe kjo falë bashkëpunimit shumë të mirë me qytetarët”, tha kryetari Begaj. Ndërsa duke folur për ndarjen regjionale, kryetari Begaj, tha se “pavarësisht prej situatës së krijuar, ne respektojnë institucionet, por problemi qëndron në faktin se, Malishevën nuk e ka pyetur askush për këtë dhe kemi reagime të ashpra të qytetarëve, e po ashtu, mendoj se ky regjionalizim është bërë pa asnjë program”, ka thënë Begaj në këtë takim.

Nda ana tjetër, drejtori i DRP-së në Gjakovë, nënkoloneli Ahmet Hasi, e ka sqaruar riorganizimin e policisë, dhe sipas tij, “pasi Gjakova është bërë regjion, dhe shumë institucione kanë kaluar në këtë regjion, përfshi edhe gjykatat, atëherë detyrimisht edhe policia është dashur të kalojë”. Edhe drejtori i DRP-së, Hasi, e ka vlerësuar të qetë dhe pa indikacione, situatën e sigurisë së përgjithshme në Malishevë dhe kjo edhe sipas tij, “duke ju falënderuar qytetarëve të Komunës së Malishevës”.

KKSB, kundër migrimit ilegal

Malishevë, 26 shkurt



Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, i drejtuar nga kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e saj të rregullt, ku kanë miratuar raportin e punës për vitin e kaluar, kanë miratuar planin e punës për vitin 2015, si dhe i kanë shqyrtuar disa pika tjera, përderisa situatën e sigurisë së përgjithshme në Malishevë, e kanë vlerësuar të qetë dhe stabile. Në fund, KKSB, ka lëshuar edhe një deklaratë për dukurinë e migrimit

ilegal.

Pas miratimit të raportit të punës dhe planit të punës për këtë vit, anëtarët e KKSB-së, e kanë vlerësuar të qetë dhe stabile situatën e sigurisë së përgjithshme dhe pa indikacione për prishjen e kësaj situate, përderisa anëtarët e KKSB-së, i kanë debatuar shumë çështje lidhur me sigurinë, një trajtim të veçantë i kanë bërë edhe migrimit ilegal, ku sipas anëtarëve dhe strukturave të rendit në vend, duhet të ndalohet kjo dukuri, edhe në Komunën e Malishevës, nuk ka qenë shumë e shprehur.

KKSB ka lëshuar këtë deklaratë, lidhur me migrimin ilegal:

“Migrimi ilegal i qytetarëve të Kosovës, jashtë vendit, kryesisht në shtetet perëndimore, është një dukuri negative dhe shqetësuese, dukuri e cila ka prekur edhe qytetarët e Komunës së Malishevës. Të gjithë ne, duhet të angazhohemi deri në maksimum, që kjo dukuri të ndërpritet, pasi kjo nuk është zgjidhje për qytetarët e Komunës së Malishevës. Rruga emigrimit ilegal, është rrugë e rrezikshme për jetën e atyre që marrin këtë rrugë, është e mundimshme dhe shumë e kushtueshme, e pa asnjë përfitim. Përfitues të vetëm të kësaj dukurie janë trafikantët, prandaj mos bini pre e mashtruesve, sepse kjo më së shumti ju dëmton ju dhe familjet e juaja. Kjo dëmton edhe imazhin e Kosovës dhe të Malishevës dhe dëmton shumë rëndë procesin e integritetit të Kosovës”.

Kryetari Begaj, takoi kryetarët e fshatrave

Malishevë, 26 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sot ka mbajtur një takim pune me kryetarët e vendbanimeve të Komunës së Malishevës, me të cilët ka diskutuar për të gjitha çështjet që lidhen me punën e komunës në raport me vendbanimet, si dhe në këtë takim, edhe Policia e Kosovës, ka prezantuar fushatën “Qëndro në vendin tënd”, duke bërë thirrje për ndërprerjen e largimit ilegal nga vendi, në mënyrë që të mos bien pre trafikantëve.

Fillimisht kryetari Begaj, i njoftoi kryetarët e fshatrave, me angazhimet e përgjithshme të komunës, planifikimet për investime kapitale dhe të tjera. “Të gjitha këto investime janë në shërbim të krijimit të kushteve më të mira për jetesën dhe rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve të Komunës së Malishevës”, tha kryetari Begaj.

Ndërsa drejtori i DRP-së në Gjakovë, nënkolonel Ahmet Hasi dhe komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina, i kanë njoftuar kryetarët e fshatrave me fushatën “Qëndro në vendin tënd”, ku sipas tyre, me këtë formë të migrimit ilegal humbin në rend të parë qytetarët dhe familjet e tyre, të cilët marrin këtë rrugë të rrezikshme, dëmtohen materialisht, dëmtohet rëndë shteti ynë në procesin e integritetit dhe në procesin e liberalizimit të vizave dhe përfitues të vetëm janë trafikantët dhe ata që duan që Kosova të vazhdojë të mbetet vend i izoluar.

Pas kësaj, përfaqësuesit e fshatrave të Komunës së Malishevës, përveç paraqitjes së kërkesave të tyre në emër të fshatit, po ashtu paraqiten edhe disa shqetësime tjera, përfshi edhe kalimin e Komunës së Malishevës, në regjionin e Gjakovës, për çka kërkuan sqarime nga kryetari i komunës.

Kryetari Begaj, fillimisht i njoftoi lidhur me kalimin në regjionin e Gjakovës dhe sqaroi se për këtë çështje nuk është pyetur askush. “Ne kemi kërkuar dhe ende kërkojmë sqarim nga ana e MAPL-së, por kurrë s’na kanë dhënë asnjë përgjigje”, ka thënë Begaj, duke ju bashkuar shqetësimeve të qytetarëve, për këtë veprim të bërë nga ana e organeve qendrore. Përfaqësuesit e fshatrave të Komunës së Malishevës, thanë se janë të shqetësuar dhe janë të indinjuar, pasi me gjenerata të tëra, ky rajon ka krijuar lidhje shpirtërore, ekonomike, miqësore, familjare, e sot, siç u tha, “për hatër apo për teke të dikujt, të këputet kjo lidhje, e krijuar prej shekujsh”.

Më pas kryetari Begaj, është përgjigjur në të gjitha pyetjet dhe kërkesat e përfaqësuesve të fshatrave, që lidhen me investime, apo për çështje tjera, të cilat me punën dhe obligimet e Komunës, në raport me banorët. “Ne do të mundohemi, që brenda mundësive, të investojmë në çdo vendbanim, pro prioritet do të jetë edhe bujqësia dhe sektorët tjerë , që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik”, tha kryetari Begaj, duke i falënderuar të gjithë përfaqësuesit e fshatrave, për bashkëpunimin e mirë.

Në këtë takim, morën pjesë 36 përfaqësues të fshatrave, nga 44 vendbanime sa i ka Komuna e Malishevës.

U prezantua plani i veprimit për MSA për Komunën e Malishevës

Malishevë, 26 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), i drejtuar nga z.Agron Maxhuni, udhëheqës i departamentit ligjor dhe për monitorimin e komunave në MAPL, me të cilët kanë biseduar për planin e veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) për Komunën e Malishevës.

Më pas, në prani edhe të drejtuesve të drejtorive komunale dhe zyrtarit komunal për integritet evropian, është prezantuar plani i veçantë për Komunën e Malishevës, plani i cili ka të bëjë me realizimin e obligimeve nga agjenda evropiane.

Prezantimin e obligimeve apo planin e veprimit për MSA, e bëri zyrtari për standarde evropiane në MAPL, z.Yll Valla, ndërsa drejtorët e drejtorive dhe zyrtarët tjerë komunal, janë njoftuar me obligimet që kanë drejtoritë përkatëse komunale, në raport me MSA-në.

U mbajtën Garat e Recitatorëve në Komunën e Malishevës

Malishevë, 28 mars



Dje në kuadër të përgatitjeve për shënimin kremtues të Festave të Marsit: Epopesë së UÇK-ës dhe Ditës së Mësuesit, u mbajtën garat e recitatorëve, ku morën pjesë të gjitha shkollat e komunës sonë. Garat u organizuan në këto nivele: Në arsimin parafillor, fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë. Këto gara janë tradicionale dhe organizohen nga Drejtoria e Arsimit dhe Edukimit në Malishevë.

Poezitë i ka karakterizuar fryma e atdhedashurisë, lirisë, luftës për çlirim e bashkim kombëtar, shtetndërtimit dhe historisë sonë kombëtare. Garat u mbajtën në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë.

Komisioni I cili, bëri vlerësimin e pikave të prezantuara në recitime, ishte në këtë përbërje:

1. Prof. Deli Thaçi-Kryetar; 2.Mr. Hanë Bytyçi -anëtar; 3.Prof. Ramadan Mazreku-anëtar.

REZULTATET FITUESE TE GARAVE TE RECITATOREVE

Nr.	Shkolla fituese	Nxënësi	Poezia	Rezultati
1	Ibrahim Mazreku	Erëza Mazreku	Qengj i ivogël	Vendi i parë
2	Ganimete Tërbeshi	Eltiona Krasniqi	7 Marsi	Vendi i dytë
3	Gjergj Kastrioti	Diellzon Krasniqi	Toka e jonë	Vendi i tretë
NVM				
Nr	Shkolla fituese	Nxënësi	Rezultati	
1	Ibrahim Mazreku	Elvira Morina	Vendi i parë	
PROGRAMI FILLOR				
Nr	Shkollat fituese	Nxënësi	Poezia	Rezultati
1	Ibrahim Mazreku	Juvenila Krasniqi	Gjuha Shqipe	Vendi i parë
2	Salih Bytyçi- Shkozë	Enisë Bytyçi	Dy lulet e lirisë	Vendi i dytë
3	Naim Frashëri	Dafinor Krasniqi	Jam shqiptar	Vendi i tretë



PROGRAMI I MESËM I ULËT				
Nr.	Shkolla fituese	Nxënësi	Poezia	Rezultati
1.	Imer Krasniqi	Eronikë Hoti	Maskarenjtë	Vendi i parë
2.	Fehmi Agani	Leonë Kastrati	Në ëndërr pashë bacë Ademin	Vendi i dytë
3.	Ismet Jashari-Kumanova	Majlindë Krasniqi	Poemë Kosovare	Vendi i tretë
ARSIMI I MESËM I LARTË				
Nr	Shkolla fituese	Nxënësi	Poezia	Rezultati
1	Gjimnazi“Hamdi Berisha”	Edonitë Hoti	Ah moj demokraci	Vendi i parë
2	Gjimnazi“Hamdi Berisha”	Edonitë Zabelaj	Mjerimi	Vendi i dytë
3.	Gjimnazi“Hamdi Berisha”	Gentianë Berisha		Vendi i tretë